

**Thirrja nga data 26.11.2024 deri në datën 29.11.2024**

**TERMAT E REFERENCESPËR  
TRE FASILITUES/E I/E TAKIMEVE ME PRINDËR NGA EKIPI PËR PARANDALIM DHE  
REAGIM NDAJ BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT NË SHKOLLIMIN E  
OBLIGUAR**

<b>Organizata</b>	OJQ “NEVO KONCEPTI”
<b>Objektiva</b>	Promovimi dhe bashkpunimi i Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisje dhe Mosregjistrimit në shkollimin e obliguar, me prindrit e nxënësve nga rradhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët përshumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.”

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synimthemelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

## **1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT**

OJQ Nevo Koncepti nga tetori 2023, ka filluar të zbatojë projektin “Fuqizimi i komuniteteve të cenueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës” në Komunën e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

Projekti është i shtritur në dymbëdhjet shkolla në tre komunat e cekura më lartë, nga ky numër në gjashtë shkolla fillore të mesme të ulta dhe gjashtë shkolla të mesme të larta profesionale. Kryesisht aktivitetet e projektit janë në lidhje me fuqizimin e nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në vazhdimsin e shkollimit, orjentim në karrierë dhe përgaditje e qëndrueshmërisë në tregun e punës.

“Fuqizimi i komuniteteve të cenueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës” është projekt tre vjeçarë i cili implementohet nga OJQ “Nevo Koncepti” në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe ka si qëllim kryesor fuqizimin e vajzave dhe djemve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë duke u ofruar atyre njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për një tranzicion të suksesshëm në moshën madhore dhe punë dinjitoze dhe të qëndrueshme.

## 2. OBJEKTIVA

Nevo Koncepti kërkon të angazhojë tre (3) Fasilitues/e për të ofruar dhe zhvilluar takimet me prindrit e nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Takimet do të zhvillohen në komunën e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës nga një takim në të trekomunat, në çdo komunë do të zgjidhet një fasilitues/e për zhvillimin e sesioneve.

Qëllimi kryesor i organizimit të këtyre takimeve është të rrisim ndërgjegjësimin dhe informimin e prindërve mbi rëndësinë e arsimit për fëmijët e tyre dhe rolin jetik të Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisje dhe Mosregjistrimit në shkollimin e obliguar, në sigurimin e një procesi arsimor të barabartë dhe të qëndrueshëm.

Këto takime po ashtu synojnë të forcojnë lidhjen midis komunitetit dhe institucioneve arsimore duke u bazuar në bashkëpunimin dhe respektinmin e ndërsjellë.

Përfshirja e prindërve dhe komuniteteve në këtë proces është një hap i rëndësishëm për të siguruar suksesin arsimor dhe integrimin shoqëror të fëmijëve.

## 3. KUSHTET QË DUHET TË PLOTSOHEN PËR KËTË ANGAZHIM

Aplikuesit duhet të jetë antarë i ekipit për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollimin e obliguar.

Të drejtë aplikimi në këtë thirrje kanë, të interesuarit nga komuna e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

## 4. REZULTATET E PRITSHME

- Prindërit do të jenë më të informuar për rëndësinë e arsimit dhe ndikimin e tij pozitiv në të ardhmen e fëmijëve të tyre.
- Prindërit do të shfaqin një interes dhe përfshirje më aktive në edukimin e fëmijëve, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre të rregullt në shkollë.
- Bashkëpunimi midis prindërve dhe mësuesve do të forcohet, duke krijuar një ambient të favorshëm për mësim.
- Me rritjen e ndërgjegjësimin dhe mbështetjes së prindërve, pritet që numri i nxënësve që braktisin shkollën ose nuk regjistrohen të ulet ndjeshëm.
- Identifikimi dhe adresimi i rasteve të rrezikuara për braktisje do të bëhet më i shpejtë dhe më efikas.
- Besimi në rolin e Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisje dhe Mosregjistrimit në shkollimin e obliguar do të rritet, duke krijuar një model bashkëpunimi afatgjatë.
- Përmes takimeve, ekipet do të marrin informacion të drejtpërdrejtë për sfidat me të cilat përballen familjet, si çështjet ekonomike, sociale ose kulturore që ndikojnë në arsimimin e fëmijëve.
- Takimet do të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të barabartë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

## 5. AFATI KOHORË I ANGAZHIMIT

Angazhimi i Fasilituesve do të fillojë sipas datave të cekura më poshtë:

- Fushë Kosovë më 03-04 dhjetor 2024
- Prizren më 04-05 dhjetor 2024
- Gjakovë më 05-06 dhjetor 2024

Fasilituesit do të kenë gjithësej dy ditë angazhimi për aktivitetin e synuar:

- Gjysem dite (0.5 ditë) për përgatitje për takimin informues;
- Një (1) ditë për fasilitimin e takimit informues me prindër dhe komunitetin rreth ekipit për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollimin e obliguar.
- Gjysem dite (0.5 ditë) për hartimin e raportit nga takimi i zhvilluar.

## 6. INFORMACIONE PËR PAGESËN

Nevo Koncepti do të paguaj Fasilituesit me një tarifë bruto ditore (nga e cila do të ndalen dhe paguhen tatimet në të hyrat dhe kontributi përsional, bazuar në ligjin e Kosovës).

Nevo Koncepti do të kryejë pagesën përmes transferit bankar në llogarinë bankare pas përfundimit dhe miratimit të detyrës dhe dorëzimit të raportit mbi angazhimin

## 7. PROCEDURAT E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Dokumenti nga shkolla i/e emruar si pjesë e Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisje dhe Mosregjistrimit në shkollimin e obliguar.
- c) Ofrimi i prezentimit në formë elektronike
- d) Oferta Financiare bruto për ditë të angazhimit

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 29.11.2024** në [m.elshani@nevokoncepti.org](mailto:m.elshani@nevokoncepti.org) / [elshanimuhamed@gmail.com](mailto:elshanimuhamed@gmail.com) duke e kopjuar (cc) në email [o.osmani@nevokonepti.org](mailto:o.osmani@nevokonepti.org)